

VENDIM
Nr. 44, datë 19.9.2016

**PËR GRANTIN E FINANCIMIT TË PROJEKTEVE TË REJA, “INFRASTRUKTURA
VENDORE DHE RAJONALE”, THIRRJA III, PËR VITIN 2016, PROGRAMI
“ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE”, SHTYLLA I**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën 1 bashkëlidhur këtij vendimi, vlera e plotë e projektit të jetë sipas vlerës së kontratës, pas përfundimit të procedurës së prokurimit. Diferenca ndërmjet vlerës së miratuar të projektit, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, me vlerën e kontratës, i shtohet portofolit të grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi “Zhvillimi i infrastrukturës vendore dhe rajonale”, shtylla I, për vitin 2016.

2. Vlera e grantit për financimin e projekteve të thirrjes III, për vitin 2016, “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi “Zhvillimi i infrastrukturës vendore dhe rajonale”, shtylla I, të jetë 1 700 000 000 (një miliard e shtatëqind milionë) lekë.

3. Vlera e grantit për thirrjen III, për vitin 2016, të financohet sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi, nga:

a) fondet që janë përfutur si diferencë ndërmjet vlerës së grantit të miratuar për të financuar, thirrjet I e II dhe vlerës totale për financimin e projekteve të reja, të miratuara nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve për thirrjen, nëpërmjet grantit “Infra-struktura vendore dhe rajonale”, programi “Zhvillimi i infrastrukturës vendore dhe rajonale”, shtylla I, dhe grantit “Shqipëria dixhitale”, programi “Shqipëria dixhitale”, shtylla III;

b) fondet e përfutura sipas pikës 1 të këtij vendimi;

c) shtesa e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, programi “Zhvillimi i infrastrukturës vendore dhe rajonale”, sipas aktit normativ nr. 1, datë 29.7.2016, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”.

4. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETAR
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1. Lista e disa prej projekteve të financuara nëpërmjet grantit 1: "Infrastruktura vendore dhe rajonale", programi "Zhvillimi i infrastrukturës vendore dhe rajonale", shtylla I, për vitin 2016.

Nr	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Nr. i vendimit të KZJHR	Vlera e plotë e projektit (lekë)	Vlera e kontratës (lekë)	Vlera e kursyer pas lidhjes së kontratës (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (lekë)	Vlera e mbetur e financimit për vitin 2017 (lekë)
QARKU BERAT								
1	Bashkia Policin	Rehabilitimi i shëtitores Miqësia	nr. 10, datë 10.3.2016	27 546 411	27 488 376	58 035	13 773 206	13 715 170
2	Bashkia Skrapar	Rikualifikimi i hapësirave përreth Pallatit të Kulturës, ruga me trafik të kufizuar/pedonalja "Pasha Hysi", ruga automobilistike "Pasha Hysi"	nr. 10, datë 10.3.2016	265 427 536	264 704 108	723 428	132 713 768	131 990 340
3	Bashkia Ura Vajguore	Rehabilitimi urban i zonës përgjatë lumit Osum, Loti 1	nr. 10, datë 10.3.2016	179 989 500	131 908 092	48 081 408	89 994 750	41 913 342
QARKU DIBËR								
4	Bashkia Dibër	Rinovim i infrastrukturës së bulevardit "Elëz Isufi", rrugës "Safet Zhulali" dhe rrugës së "Muzeut"	nr. 10, datë 10.3.2016	110 726 698	104 789 063	5 937 635	55 363 349	49 425 714
5	Bashkia Dibër	Përmirësimi i infrastrukturës vendore dhe rivitalizim i hapësirave publike në zonën pranë Pallatit të kulturës	nr. 10, datë 10.3.2016	207 649 090	207 506 697	142 393	103 824 545	103 682 152
QARKU DURRËS								
6	Bashkia Shijak	Rikualifikim i sheshit të lagjes "Lagjina"	nr. 31, datë 13.6.2016	25 202 594	25 093 368	109 226	12 601 297	12 492 071
7	Bashkia Krujë	Zgjerim i rrugës hyrëse të qytetit, parkimi dhe rikualifikimi i qendrës së qytetit	nr. 10, datë 10.3.2016	366 281 871	364 453 272	1 828 599	183 140 936	181 312 336
QARKU ELBASAN								
8	Bashkia Belsh	Projekti i Ansambli Rilindja, Belsh	nr. 10, datë 10.3.2016	180 801 690	179 957 360	844 330	90 400 845	89 556 515
9	Bashkia Elbasan	Rikonstruksion i rrugës rurale Qaf Hajdarun - Byshek	nr. 10, datë 10.3.2016	183 168 845	181 222 161	1 946 684	91 584 423	89 637 738
10	Bashkia Elbasan	Sistemim-asfaltim i rrugës "28 Nëntori"	nr. 10, datë 10.3.2016	194 988 741	190 995 623	3 993 118	97 494 371	93 501 252
11	Bashkia Peqin	Ura e Ishutit Grykesh, te Njësia Administrative Pajove, bashkia Peqin	nr. 10, datë 10.3.2016	3,840,680	3 571 337	269 343	1 920 340	1 650 997
QARKU FIER								
12	Bashkia Divjakë	Segmenti 3 i Pasurëlës+ Urë në dru përgjatë rrugës automobilistike, Hyrje Parkut-Godulla e Brendshme	nr. 10, datë 10.3.2016	102 130 235	99 495 414	2 634 821	51 065 118	48 430 296
13	Bashkia Fier	Ndërtim i parkut qendror të qytetit, rehabilitim i rrugës Xoxi Andoni dhe hapësirat rreth saj	nr. 10, datë 10.3.2016	300 126 792	298 786 258	1 340 534	150 063 396	148 722 862
14	Bashkia Fier	Rivitalizim i parkut pranë bur Rinisë dhe rehabilitim i rrugës Dervish Hekali	nr. 10, datë 10.3.2016	147 498 882	143 730 840	3 768 042	73 749 441	69 981 399
15	Bashkia Lushnjë	Rotondo e Phagut-Postoblok, ruga e hyrjes Lushnje-Tiranë, (faza e dyte)	nr. 10, datë 10.3.2016	106 224 781	102 989 042	3 235 739	53 112 391	49 876 651
16	Bashkia Patos	Shëtitore " Republika"	nr. 10, datë 10.3.2016	98 615 048	96 285 666	2 329 382	49 307 524	46 978 142
17	Bashkia Patos	Ndërtimi i rrugës Ruzhdië - Gjinoqar	nr. 10, datë 10.3.2016	66 213 456	37 003 000	29 210 456	33 106 728	3 896 272

18	Bashkia Roskovec	Projekt zhvillimor për fshatin Kuman	nr. 31, datë 13.6.2016	30 548 315	28 800 000	1 748 315	15 274 158	13 525 842
19	Bashkia Roskovec	Sistemin , asfaltim i rrugës së fshatit Kurjan	nr. 31, datë 13.6.2016	148 286 386	143 835 890	4 450 496	74 143 193	69,692,697
QARKU GJIROKASTËR								
20	Bashkia Gjirokastrë	Rikonstruksion i hapësirave publike dhe rrugës hyrëse pranë Memorialit të Rilindasve në Gjirokastrë	nr. 10, datë 10.3.2016	99 755 007	58 220 247	41 534 760	49 877 504	8 342 743
21	Bashkia Këlcyre	Rikualifikim urban përreth përroit në lagjen "Gur" si edhe sistemin i shtrimit të përroit	nr. 10, datë 10.3.2016	67 810 604	67 757 108	53 496	33 905 302	33 851 806
22	Bashkia Memaliaj	Projekti i Ansambllit Arkitektonik të sheshit Minatori, Memaliaj	nr. 10, datë 10.3.2016	151 350 288	98 683 679	52 666 609	75 675 144	23 008 535
23	Bashkia Tepelinë	Hyrya Ali Pasha vazhdimi i shëtitores përgjatë kalasë	nr. 31, datë 13.6.2016	149 984 392	147 599 953	2 384 439	74 992 196	72 607 757
QARKU KORÇË								
24	Bashkia Devoll	Rikualifikim urban i qendrës së qytetit Biliisht, Lati 1	nr. 10, datë 10.3.2016	124 315 222	123 043 330	1 271 892	62 157 611	60 885 719
25	Bashkia Kolonjë	Rikonstruksion i rrugëve dhe fundave të sheshit "Rilindja" Ersekë	nr. 10, datë 10.3.2016	51 858 597	51 132 805	725 792	25 929 299	25 203 506
26	Bashkia Korçë	Restaurimi i objekteve të pazarrit Korçë, Lote 2	nr. 10, datë 10.3.2016	167 166 000	162 438 077	4 727 923	83 583 000	78 855 077
27	Bashkia Korçë	Rikonstruksion i qendrës dhe infrastrukturës rrugore dhe monumenteve të kulturës, Voskopojë	nr. 10, datë 10.3.2016	370 000 000	362 983 320	7 016 680	185 000 000	177 983 320
28	Bashkia Korçë	Rikualifikim urban i zonës përreth qytetës së fëmijëve, Korçë	nr. 31, datë 13.6.2016	396 195 200	368 063 408	28 131 792	198 097 600	169 965 808
29	Bashkia Maliq	Rehabilitim rruga hyrëse "Pylli i Fazanëve"	nr. 10, datë 10.3.2016	28 071 408	17 296 544	10 774 864	14 035 704	3 260 840
QARKU KUKËS								
30	Bashkia Has	Rehabilitimi i godinave, sheshëve dhe qendrës së qytetit Kramë-Has	nr. 10, datë 10.3.2016	106 997 427	103 390 324	3 607 103	53 498 714	49 891 610
31	Bashkia Tropojë	Shëtitoreja e qytetit Bajram Curri/	nr. 31, datë 13.6.2016	149 270 311	114 949 590	34 320 721	74 635 156	40 314 434
32	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion i rrugës Bajram Curri - Vernicë	nr. 10, datë 10.3.2016	65 376 393	41 873 880	23 502 513	32 688 197	9 185 683
QARKU LEZHË								
33	Bashkia Lezhë	Lulishte dhe parkimi përballë gjimnazit "Hydrijet Lezhë", lagje "Besëlidhje"	nr. 10, datë 10.3.2016	25 200 932	21 924 252	3 276 680	12 600 466	9 323 786
34	Bashkia Mirditë	Rikualifikimi urban i sheshit të qytetit Rrëshen	nr. 10, datë 10.3.2016	186 901 843	172 020 124	14 881 719	93 450 922	78 569 202
QARKU SHKODËR								
35	Bashkia Pukë	Sistemin i lagjes pas Pallatit të Kulturës	nr. 10, datë 10.3.2016	28 390 307	27 659 507	730 800	14 195 154	13 464 353
36	Bashkia Shkodër	Rikonstruksion i bllokut të pallateve "Xhabije"	nr. 10, datë 10.3.2016	76 654 597	46 519 616	30 134 981	38 327 299	8 192 317
QARKU TIRANË								
37	Bashkia Kavajë	Rehabilitimi i përroit Leshnig, Kavajë	nr. 10, datë 10.3.2016	450 000 000	446 006 592	3 993 408	225 000 000	221 006 592
38	Bashkia Rrogozhinë	Rivitalizimi urban i qendrës së qytetit të Rrogozhinës	nr. 31, datë 13.6.2016	149 996 829	149 983 775	13 054	74 998 415	74 985 360
39	Bashkia Tiranë	Rikualifikimi urban i Sheshit Skënderbej, Faza e I	nr. 31, datë 13.6.2016	640 084 160	633 043 125	7 041 035	320 042 080	313 001 045
40	Bashkia Vorë	Sistemin asfaltim rrugë lidhëse urbane Pushë Prezë Ura e Limathit - Bërcullë - Bashkia Vorë	nr. 31, datë 13.6.2016	149 243 886	148 943 867	300 019	74 621 943	74 321 924
QARKU VLORË								
41	Bashkia Himarë	Rikualifikim urban i sheshit Borsh	nr. 10, datë 10.3.2016	26 467 315	26 133 332	333 983	13 233 658	12 899 674
42	Bashkia Himarë	Rikualifikim urban i	nr. 10, datë					

		sheshit Lukovë	10.3.2016	89 461 945	83 999 999	5 461 946	44 730 973	39 269 026
43	Bashkia Sarandë	Rikonceptim dhe rivitalizim i qendrës së qytetit Sarandë, Rruga e flamurit	nr. 10, datë 10.3.2016	105 643 979	102 518 468	3 125 511	52 821 990	49 696 478
44	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Sistemin asfaltim i rrugës së Unazës Vlorë (Poliklinika -7Pallatet)	nr. 10, datë 10.3.2016	582 999 971	416 132 539	166 867 432	291 499 986	124 632 553
TOTALI				7 184 464 164	6 624 933 029	559 531 135	3 592 232 092	3 032 700 937

Shënim:

1. “Vlera e projektit” përfaqëson vlerën e projektit të miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
2. “Vlera e kontratës” përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, dhe “korrekton” vlerën e projektit. Vlera e kontratës përcillet nga sekretarati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban).
3. “Vlera e kursyer pas lidhjes së kontratës”, përfaqëson vlerën e përfutur nga diferenca ndërmjet vlerës së projektit dhe vlerës së kontratës. Fondi i krijuar nga kjo diferencë i shtohet fondit të grantit të infrastrukturës vendore dhe rajonale.
4. “Vlera e financimit për vitin 2016” tregon vlerën e shpërndarë si financim për vitin 2016, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
5. “Vlera e mbetur e financimit për vitin 2017” tregon e vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës ndërmjet vlerës së kontratës dhe vlerës së financimit për vitin 2016.

Tabela 1. Vlera e grantit, për thirrjen III, për vitin 2016, granti 1: “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi “Zhvillimi i infrastrukturës vendore dhe rajonale”, shtylla I, për vitin 2016.

Nr.	Emërtimi i burimit	Vlera e grantit
1	Fondi sipas pikës 3/a të këtij vendimi	581 500 903
2	Fondi sipas pikës 3/b të këtij vendimi	418 499 097
3	Fondi sipas pikës 3/c të këtij vendimi	700 000 000
TOTALI		1 700 000 000